



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.1009/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Sharr Cem shpk me seli në Hani i Elezit, rr.Adem Jashari nr.280, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson D.P. avokat në Prishtinë, kundër të paditues Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi-kthimi i akcizës, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.1620/2018 të datës 08.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 06.07.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit Sharr Cem shpk me seli në Hani i Elezit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1620/2018 i datës 08.02.2021, Vërtetohet

A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, duke aprovuar si të bazuar Kërkesëpadin e paditësit Sharr Cem shpk me seli në Hani i Elezit, ka anuluar Vendimin nr.01.3.2.2/205 datës 15.05.2018 i të paditues Dogana e Kosovës në Prishtinë, dhe Lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kundër këtij aktgjykimi, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit D.P. avokat në Prishtinë, ka ushtruar ankesë me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të; shkeljes thelbësore të dispozitave të së drejtës procedurale, me propozimin që gjykata e apelit, të aprovoj ankesën në tërsi si themeltë të padiësit, të Ndryshohet pjesërisht pika II e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.1620/2018 të datës 08.02.2021, ashtu që krahas anulimit të aktvendimit nr.01.3.2.2/205 datës 15.05.2018 i të paditues Dogana e Kosovës në Prishtinë, Detyrohet i padituri që ti kthej paditësit pjesën e pa kthyer-pa rimbursuar të kërkesës së paditësit për kthimin e taksës së akcizës për produktet vajra të rëndë për ngrohje, datës 25.01.2018 në shumën prej 81,388.00€, me kamatë ligjore në shkallën prej 8% në vit.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 49 të LKA-së, gjen se;

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se në procedurën administrative të ankesave, e paditura me Vendimin nr.01.3.2.2/205 datës 15.05.2018, ka Refuzuar si të pabazuar ankesën e subjektit në procedurë Sharr Cem shpk me seli në Hani i Elezit, për rishqyrimin e aktvendimit nr.150/25.01.2018 i lëshuar nga Sektori i Akcizës, si e pabazuar.

Kundër këtij aktvendimi përfundimtar të nxjerr në procedurën administrative, nga e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, paditësi përmes përfaqësuesit të autoizuar D.P. avokat në Prishtinë, me padi inicion konflikt administrativ, në Gjykatën e shkallës së parë, e cila pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor të datës 08.02.2021, në praninë e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe administrimit të provave, si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin Aprovon si të bazuar Kërkesëpadin e paditësit Sharr Cem shpk me seli në Hani i Elezit, ka anuluar vendimin nr.01.3.2.2/205 datës 15.05.2018 i të paditues Dogana e Kosovës në Prishtinë, dhe Lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në aktgjykimin e atakuar gjykata e shkallës së parë, thekson se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes juridike-administrative. Konsatimi në arsyetim të vendimit kontestues është kontradiktor i paqëndrueshëm dhe i pa mbështetur në prova materiale, sepse njëher përmend faktin se “subjekti parashtrues i kërkesës ka arsyetuar sasinë prej 2,064.920 kg apo 2,152,206.18 litra vaj të rëndë për ngrohje, në proces të prodhimit”, ndërsa në pasusin tjetër cek se “subjekti ka gëzuar të drejtën për rikthim të mjeteve për sasinë prej 1,747.789.00kg,1,826,654,21 litra vaj të rëndë për ngrohje, për të cilën sasi edhe ka aprovuar kërkuesin për rikthim të mjeteve”, dhe vijon arsyetimi se Sektori i akcizës ka vepruar drejt kur për sasinë prej 314,120.00kg/327,452.07litra vaj të rëndë për ngrohje, nuk ka kthyer mjetet, mirpo kjo vetëm e ka rënduar situatën duke krijuar paqartësi faktike dhe juridike në kuptim të asaj se cilat të drejta i ka gëzuar subjekti me autorizimin nr.07/2017 dt.20.12.2016, për cilën sasi ka vlejti ky autorizim, sa ka qenë normativi i lejuar dhe ai i shfrytëzuar në periudhën e mbuluar me autorizim, andaj me këtë gjykata konstaton se e paditura ka krijuar paqartësi faktike dhe juridike e cila nuk ka mundur të sqarohet as me ekspertizë të datës 30.11.2020. Gjykata në rivendosje e obligon të paditues që në riprocedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të aktgjykimit.

Dhomat e shkallës së Dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, Ligjit të

Procedurës Kontestimore, dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar si në vështrim të nenit 81G të Ligjit 04/L-102 për ndryshimin dhe Plotsimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat 03/L-222, në drejtim të thënies në padi, përgjigjes në padi, dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesorë dhe ka vlerësuar drejtë, se kërkesë padia e paditësit është e bazuar, duke e aprovuar kërkesëpadin e paditësit, ka anuluar vendimin kontestues të paditues, si dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim rivendosje. Kolegji

vlersoi se të metat e gjetura nga gjykata e shkallës së parë në vlersimin e ligjshmëris së vendimit të kontestuar janë të drejta, e cila me të drejt ka kërkuar nga e paditura në rivendosje të eliminoj vërejtet e dhëna në arsyetim të aktgjykimit.

Pretendimet ankimore të paditësit se aktgjykimi i apeluar është i pabazuar dhe kundërthënës, sepse vërtetimi i fakteve është i mjaftueshëm nga gjykata e shkallës së parë, që mos të kthej çështjen në rishqyrtim, por të konstatoj se kërkesa për kthimin e akcizës ishte në pajtim të plotë me autorizimin, Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, nuk i aprovoi këto pretendime si të bazuara. Nga vendimet administrative kontestuese të paditures, edhe Kolegji gjen parregullsi në dispozitiv të këtyre vendimeve, e veqanërisht në dispozitiv të vendimit nr.150/25.01.2018 nga Dogana e Kosovës, Sektori i Akcizës, duke aprovuar pjesërisht kërkesën e paditësit për kthimin e taksës së akcizës së paguar për produktin akcizor “vaj i rëndë për ngrohje”, në sasinë prej 2,064,920.00kg apo 2,152,206.18 litra, përderisa në arsyetim të këtij akti administrativ, jepet një tjetër sasi e produktit akcizor prej 1,747,879,00kg/1,826,654,21litra, për të cilën paditësit i është lejuar kthimi i akcizës.

Gjithashtu si fakte tjera që e kanë pamundësuar marrjen e vendimit meritor nga gjykata e shkallës së parë, është se e paditura nuk jep shpjegime faktike dhe juridike, se cila ka qenë data e fillimit të kalkulimit të afatit 1 vjeçar për pjesën refuzuese të kërkesës, pastaj cilat fatura furnizuese e të paguara nuk janë pranuar nga e paditura. Gjukata e shkallës së parë me të drejt i ka bërë të ditur paditures, që në rivendosje të kihet parasysh dispozita e nenit 239 par.1 i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, sa i përket afatit 1 vjeçar për parashtrimin e kërkesës për kthimin e taksës së akcizës, ashtu që vihet në dilemë edhe vlefshmëria e autorizimit 07/2017 në raport me këtë dispozitë ligjore.

Kolegji vlersoi, se gjykata e shkallës së parë me të drejt është referuar në legjislacionin doganor dhe administrativ në fuqi, andaj pretendimet e tjera të paditësit në ankes, kjo gjykat nuk i aprovoi si me ndikim që mund të ndryshojn gjendjen e vërtetuar faktike në konflikt administrativ nga gjykata e shkallës së parë.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, Dhomat e shkallës së dytë, konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cënuar ligji në dëm të paditësit. Andaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, ngase nuk është shkelur ligji material në dëm të paditësit.

Nga të lartcekurat e në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1009/2022 datë 06.07.2023

Kryetari i Kolegjit-gjyqtari,
Krenar Berisha